



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 17.12.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION I OBJEKTIT EKZISTUES 2 DHE 4 KATE DHE
OBJEKT I RI 2 DHE 3 KATE, SPITALI I PEQINIT”, ME VENDNDODHJE NË
BASHKINË PEQIN

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjekti zhvillues Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion i objektit ekzistues 2 dhe 4 kate dhe objekt i ri 2 dhe 3 kate, Spitali i Peqinit”, me vendndodhje në Bashkinë Peqin, me subjekt zhvillues Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor,
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Peqin.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

ALBANA KOÇIU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 07/03 2025